

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 2215 Rep.

Nr. 167 Kol.



KONTRATE SHITBLERJE AKSIONESH

Ne Tirane, sot me date 26 Dhjetor 2002 (dymije e dy), para meje Mimoza Papa, Notere me seli ne rrugen "Reshit Çollaku", pallatet Shallvare, u paraqiten personalisht personat e meposhtem:

Ne cilesine e Shitesit: Aksioneret e shoqerise anonime pa oferte publike "Media 99" sh.a., rregjistruar si person juridik me Vendimin Nr.23817 date 17.05.2000 te Gjykates se Rrethit Tirane

- 1- **Nikolle Lesi**, i biri i Palit, i datelindjes 6/08/1963, banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar me pasaporten nr.0014244, zoterues i 800 aksioneve te barasvlefshme me 40 % te kapitalit themeltar te shoqerise;
- 2- **Natalia (Ucaj) Lesi**, e datelindjes 18/03/1965, banuese ne Tirane, madhore me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar me pasaporten nr.0014529, zoteruese e 800 aksioneve te barasvlefshme me 40 % te kapitalit themeltar te shoqerise.
- 3- **Vullnet Musaraj**, i datelindjes 13/12/1946, banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar me pasaporten nr.Z 0040427, zoterues i 400 aksioneve te barasvlefshme me 20 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

A vertical column of four handwritten signatures. The top signature is the most legible, appearing to be "Lesi". The other three are more stylized and difficult to read.

Two large handwritten signatures at the bottom of the page. The one on the left is very stylized and appears to be "Mimoza Papa". The one on the right is also stylized and appears to be "Vullnet Musaraj".



Ne ciesine e Bleresit:

- 1- **Agron Duka**, i biri i Enverit, i datelindjes 1958, banues ne Shijak, madhor me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar me pasaporten nr.0014945.
- 2- **Armand Duka**, i biri i Enverit, i datelindjes 1962, banues ne Shijak, madhor me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar me pasaporten nr.0012167.
- 3- **Lefter Koka**, i biri i Hakiut, i datelindjes 4/08/1964, banues ne Durres, madhor me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar me pasaporten nr.0307047.
- 4- **Ardian Abazi**, i biri i Bekut, i datelindjes 8/04/1958, banues ne Durres, madhor me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar me pasaporten nr.0121088.

Objekti i kontrates:

Me Vendimin e Asamblese se Aksionereve te shoqerise te dates 25.12.2002, aksioneret e shoqerise "Media 99" sh.a., kane vendosur shitjen e aksioneve te kesaj shoqerie.

Neni 1

Shitesit, aksioneret e shoqerise "Media 99" sh.a., u shesin Bleresave 2000 aksionet e shoqerise qe ata zoterojne, te cilat Bleresit i blejne ne raportet e meposhtme:

- | | |
|------------------------|---|
| 1- Lefter Koka | - 800 aksione, perkatesisht 40 % te kapitalit te shoqerise |
| 2- Agron Duka | - 500 aksione, perkatesisht 25 % te kapitalit te shoqerise |
| 3- Armand Duka, | - 500 aksione, perkatesisht 25 % te kapitalit te shoqerise |
| 4- Ardian Abazi | - 200 aksione, perkatesisht 10 % te kapitalit te shoqerise. |

Neni 2

Çmimi i shitjes se ketyre aksioneve ,vlera e tyre, eshte paguar prej Bleresave jashte kesaj zyre noteriale dhe Shitesit deklarojne se e kane marre kete shume dhe se nuk kane asnje pretendim per pagesen.



Neni 3

Me shitjen e aksioneve te shoqerise "Media 99" sh.a., Shitesit largohen si aksionere te kesaj shoqerie dhe Bleresat behen aksionere me te drejta te plota te shoqerise "Media 99" sh.a. ne raportet e mesiperme.

Neni 4

Ne çmimin e blerjes se aksioneve te shoqerise jane te perfshira te gjitha pasurite, sendet e kesaj shoqerie, te luajtshme, aktivet e saj dhe dorezimi i tyre do t'u behet Bleresave sipas procesverbalit te mbajtur per inventarizimin e tyre. Proces verbal i cili eshte pjese perberese e kesaj kontrate.

Neni 5

Shitesit garantojne Bleresat ne gezimin e qete te prones dhe deklarojne se shoqeria nuk ka asnje detyrim ndaj institucioneve shteterore, apo te treteve dhe marrin persiper te gjitha detyrimet e shoqerise, qe ka ose mund te lindin, qe i perkasin periudhes prej krijimit te saj deri ne kalimin e pronesise Bleresave

Neni 6

Kjo kontrate hartohet ne 5 (pese) kopje me te njejten vlere ligjore, e cila pasi lexohet prej paleve e ata e gjejne ne perputhje me vullnetin e tyre te lire e te plote e nenshkruajne rregullisht ne pranine time. Une, noterja e legalizoj sipas ligjit.

PALET KONTRAKTORE

SHITESIT

NIKOLLE LESI

BLERESIT

AGRON DUKA

04

NATALINA UCAJ
Natalina Ucaj (des)
N

VULLNET MUSARAJ
Vullnet Musaraj
V

ARMAND DUKA
Armand Duka
A

LEFTER KOKA
Lefter Koka
L

ARDIAN ABAZI
ARDJAN ABAZAJ
A

NOTERE
MIMOZA PAPA
Mimoza Papa
M
2002